



Planuar / Doretuar Prilajen/Prodato Received/Delivery	05-09	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHCK	5155/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.730/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.730/2022 të datës 23.08.2022 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë rruga kundër organit të punësimit/Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 05.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.730/2022 të datës 23.08.2022 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar sipas përshkrimit në ankesë në pozitën Mësimdhënëse në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza” në Prizren, përmes postës më date 19.08.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 23.08.20232 dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.730/2022 me Nr. Prot:4920/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.730/2019 e datës 23.08.2022 me numër protokolli 4920/2022 drejtuar Këshillit të Pavarur



Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për ndërrimin e kontratës së punës nga edukatore në mësimdhënëse dhe ndryshimin në pagë e datës 24.06.2019 nga ankuesja; Kërkesën e datës 28.04.2021 nga Organizata Sindikale e QBMK Nënë Tereza; Vendimin me Nr. 1676/2-1K i datës 21.09.2021; Kallëzim Penal i datës 28.10.2021; Plotësi i kallëzimit penal i datës 03.03.2022; Kërkesën e datës 07.04.2022, 13.10.2014 të ankueses; Procesverbal për marrjen e deklaratës nga e dëmtuara në procedurë paraprake PPN/II.nr,1018-15/21; Njoftim për pranueshmëri i datës 08.06.2022 Ankesë C.nr.2148/2021; Ankesën e datës 15.02.2022 nga ankuesja për Ministrinë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Ankesën e datës 22.12.201 për Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa të Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; nga ankuesja; Ankesë për anulimin e konkursit e datës 23.08.2021 nga ankuesja për Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa të Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Padi për Gjykatën Themelore në Prizren e datës 06.10.2021 nga ankuesja; Zarkin e datës 19.08.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të provave të lëndës, ka konstatuar që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, *sepse*:

Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në nenin 2 ka paragrafi 2 ka kategorizuar zyrtarët publikë në: 2.1. *nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil)*; 2.2. *nëpunësi i Shërbimit Publik*; 2.3. *nëpunësi i Kabinetit*; dhe 2.4. *nëpunësi administrativ dhe mbështetës*, bazuar në këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Arsimore të Kosovës kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, siç parashihet me nenin 2 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcaktohet se: *"Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtëpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, mbi këtë bazë pozita që mban ankuesja Mësimdhënëse në Qendrën Brimore për Mësim dhe Këshillim "Nënë Tereza" në Prizren nuk hyn në kategorinë e nëpunësve civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet që Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses.*

Në kuptim të kësaj dhe nenit 24 paragrafi 4, nenit 74 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë të ankohet tek punëdhënësi pastaj mund të filloj kontestin administrativ në gjykatën kompetente.

Siç u tha më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.730/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Avokat
- Sekretarit të Ministrisë se Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Udhëheqësit tw Udhëheqësit tw Burimeve Njerëzore të Ministrisë se Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Arkivit të KPMSHCK-së

